



KOLEGJI - COLLEGE
PJETËR BUDI
Prishtinë - Prishtina

24/2016 Data 27.11.2016

KOLEGJI "PJETËR BUDI" - PRISHTINË

**RREGULLORE MBI PROCEDURËN E DIPLOMIMIT TË
STUDENTËVE NË STUDIMET BAÇELOR**

Prishtinë, 2016

Tel: 038 234 566, 044 163 372 / 049 163 372 / Email: pjeterbudi@gmail.com
www.pjeterbudi.com / Adress: Rr. "Mujë Krasniqi" p.n. Ulpiene, Prishtine



Në bazë të nenit 34 dhe 39 paragrafi 1.9 të Statutit, Senati Akademik i Kolegjit "Pjetër Budi" – Prishtinë me datë 04.11.2016, miratoj dhe aprovoj:

RREGULLORE MBI PROCEDURËN E DIPLOMIMIT TË STUDENTËVE NË STUDIMET BAÇELOR

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Me këtë Rregullore përcaktohen:

Neni 1

1. Procedurat e punimit të tezës baçelor;
2. Procedura e verifikimit të dosjes së studentit;
3. Procedura e diplomimit;
4. Lëshimi i diplomës për studentët e diplomuar të (në tekstin e mëtejme: Kolegji)

Neni 2

- 2.1. Kohëzgjatja e studimeve themelore Baçelor është 3 (tri) vite akademike, përkatësisht 180 ECTS kredi në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë në Kosovë dhe Statutin e Kolegjit..
- 2.2. Pas përfundimit të kursit të plotë të studimeve themelore në Baçelor, studentët duhet ta punojnë Temën Baçelor, për të fituar kualifikimin përkatës shkencor.
- 2.3. Diplomimi i studentit bëhet me nënshkrimin e vendimit nga komisioni për aprovimin e Temës Baçelor të studentit.
- 2.4. Tema Baçelor punohet nën mbikëqyrjen e Mentorit i cili ka udhëzuar studentin deri në përfundimin e temës..
- 2.5. Pas aprovimit të temës nga mentori nënshkruhet vendimi i Komisionit të caktuar për diplomimi të studentit.

II. PUNIMI I TEZËS BAÇELOR

Neni 3

- 3.1. Të gjitha programet e studimeve themelore baçelor të Kolegjit, përfundojnë me punimin e Temës Baçelor - Bachelor Thesis.
- 3.2. Punimi i tezës BA është një punë e pavarur e studentit, në formë të një projekti, të një studimi me karakter të përgjithshëm, i cili lidhet me një disiplinë të vetme shkencore, apo edhe me shumë disiplina të përafërta, kur punimi ka karakter kompleks.



- 3.3. Punimi i tezës BA elaborohet individualisht nga studenti, duke vërtetuar se aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimit, mund të shfrytëzohen me sukses për zgjidhjen e problemeve praktike në fushat e caktuara shkencore dhe hulumtuese.

Neni 4

- 4.1. Studenti ka të drejtë të fillojë shtjellimin e temës BA në semestrin e gjashtë (6). Studenti në bashkëpunim me mentorin e lëndës, përcaktohet për temën të cilën do ta elaborojë.
- 4.2. Gjatë punimit të tezës BA, studenti është i obliguar që të konsultohet me mentorin lidhur me formën, përmbajtjen, shtjellimin dhe përfundimin e punimit.
- 4.3. Punimi BA hartohet sipas udhëzimit të përcaktuar nga Kolegji të cilin studentët mund ta marrin në administratë i cili udhëzim është shtojcë e kësaj rregulloreje.
- 4.4. Mentori i kandidatit e ka obligim të bëjë evidencimin e takimeve të cilat i ka pasur me kandidatin për konsultim rreth shtjellimit të temës relevante. Evidencimi i takimeve bëhet në formularin unik të përgatitur nga Kolegji.
- 4.5. Pas përfundimit të të gjitha konsultimeve, dhe finalizimit të temës BA, studenti është i obliguar që në administratën e Kolegjit të dorëzojë 5 (pesë) kopje të punimit, të lidhura në kopertina të forta.
- 4.6. Përcaktimi i datës për diplomim, bëhet nga Udhëheqësi i Programit Studimore përkatës, e cila mund të jetë jo më vonë se 1 muaj, nga dita e dorëzimit të punimit BA në administratën e Kolegji.

III. PROCEDURA E MBROJTJES SË PUNIMIT BA

Neni 5

- 5.1. Pas dorëzimit të punimit në kopje të mjaftuara, (shih nenin 4.3), Udhëheqësi i Programit Studimore përkatës me vendim të posaçëm përcakton Komisionin për vlerësimin e Temës Baçelor.
- 5.2. Komisioni për vlerësimin e Temës Bachelor, përbëhet nga tre anëtarë.
- 5.3. Anëtarë të komisionit për mbrojtje të punimit BA, duhet të jenë profesorë, ligjërues të Kolegjit. Njëri nga anëtarët e komisionit duhet të jetë Mentori i studentit, e në mungesë të tij ndonjë ligjërues nga fusha përkatëse e lëndës ku është punuar tema BA.

Neni 6

- 6.1. Studentit i lejohet që të mbrojë Temën Baçelor, në momentin kur konstatohet se:
- 6.1.1. Studenti i ka përfunduar të gjitha provimet e parapara me plan programin studimor, dhe ka arritur minimum notën mesatare 6.00;
- 6.1.2. Tema e zgjedhur për punim e temës baçelor i përmbush kërkesat të cilat i ka paraparë mentori i lëndës;



6.1.3. Studenti i ka likuiduar të gjitha detyrimet financiare dhe materiale, të cilat i ka pasur ndaj Kolegjit, në bazë të kontratës apo edhe aneks kontratës.

Neni 7

7.1. Jo më larg se pesë (5) ditë nga data e formimit të komisionit për vlerësim të temës baçelor, komisioni duhet të takohet për vlerësimin e temës.

7.2. Kryetari i Komisionit për vlerësimin e Temës Baçelor, fillimisht konstaton se a janë plotësuar kriteret në bazë të kësaj rregulloreje, për vlerësimin e temës.

7.3. Mentori i Kandidatit e bën një prezantim të shkurtër të temës për vlerësim para komisionit, pastaj anëtarët e tjerë të komisionit e bëjnë vlerësimin individualisht dhe në fund merret vendimi i vlerësimit.

7.4. Në vendimin e vlerësimit caktohet edhe nota e Temës Baçelor.

7.5. Për notimin e temës komisioni merr për bazë aspektin metodologjik dhe empirik të punës kërkimore dhe shkencore si dhe rezultatit hulumtues në të cilin ka arritur student i gjatë shtjellimit të Temës Baçelor.

7.6. Notimi mund të bëhet sipas kriterëve për vlerësim edhe në provime d.m.th. me notën: 6 (gjashtë), 7 (shtatë), 8 (tetë), 9 (nëntë), dhe 10 (dhjetë).

7.7. Kryetari i Komisionit, në prani të anëtarëve të tjerë të komisionit me miratimin edhe të anëtarëve tjerë, e vendos notën dhe e nënshkruan vendimin për diplomim të studentit.

Neni 8

8.1. Tema Baçelor është punim kërkimor – empirik dhe nuk mbrohet publikisht nga studentit.

8.2. Studenti i cili i ka plotësuar kriteret në bazë të nenit 4.3 dhe 6.1 të kësaj rregulloreje, më së largu 5 (pesë) ditë nga data e nënshkrimit të vendimit për diplomim njoftohet nga Administrata e Kolegjit për nënshkrimin e vendimit nga ana e komisionit për Temën Baçelor.

8.3. Me nënshkrimin e vendimit nga komisioni për vlerësim të Temës Baçelor, studentit konsiderohet i diplomuar dhe i takojnë të gjitha të drejtat sipas Statutit të Kolegjit dhe legjislacionit pozitiv në Republikën e Kosovës për të diplomuarit.

IV. NOTA MESATARE

Neni 9

9.1. Nota mesatare e studentit llogaritet sipas sistemit legjislacionit të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës.

9.2. Të gjitha notat e studentit të fituara gjatë tri viteve të studimeve së bashku me notën e Temës Baçelor së pari mbledhen dhe formojnë shumën e përgjithshme, kjo shumë e përgjithshme pjesëtohet me numrin e përgjithshëm të lëndëve dhe Temën Baçelor.



9.3. Shembull ilustrativ studenti ka arritur shumën 240 prej 29 provimeve plus tema baçelor 1, në total bëjnë 30 lëndë, kur i pjesëtojmë $240/30=8.00$

9.4. Nota minimale mesatare për diplomimi është 6.00.

9.4. Nota maksimale mesatare që mund të fitoj një student është: 10.00.

VI. LËSHIMI I DIPLOMËS

Neni 10

- 10.1. Studenti i cili e punon me sukses punimin BA dhe merr notën kaluese (6, 7, 8, 9 apo 10) konsiderohet i diplomuar.
- 10.2. I diplomuari pajiset me Diplomën si dhe me shtojcën e diplomës, sipas kriterëve të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe të Teknologjisë së Republikës së Kosovës.
- 10.3. Diploma i lëshohet të diplomuarit në afat prej 4 (katër) javësh, nga dita e diplomimit.
- 10.4. Diploma nënshkruhet nga rektori dhe udhëheqësi i programit studimor përkatës.
- 10.5. Deri në përgatitjen e diplomës BA, Kolegji do ti lëshojë të diplomuarit Certifikatën e Diplomimit dhe pasqyrën e notave, në të cilën shënohen të gjitha lëndët me notat përkatëse, kreditë (ECTS), etj.

Neni 11

- 11.1. Pas përfundimit me sukses të studimeve trevjeçare në Kolegj, studentët e diplomuar marrin gradën shkencore:
 1. Baçelor i Arteve i Doganës dhe Shpedicionit,
 2. Baçelor i Arteve i Menaxhimit të Turizmit dhe Hotelërisë,
 3. Baçelor i Arteve i Sigurimeve,
 4. Baçelor i Arteve i Administrim Biznesit.

Neni 12

- 12.1. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën miratimit dhe nënshkrimit nga Rektori i Kolegjit "Pjetër Budi"- Prishtinë.
- 25.2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për diplomimin e studentëve Nr. 1063/2014 e datës 24.10.2014.

Prishtinë
dt. 04.11.2016

Rektori i Kolegjit

Prof. Ass. Dr. Hashim REXHEPI



KOLEGJI - COLLEGE
PJETËR BUDI
Prishtinë - Prishtina

FAQJA E PARË

KOLEGJI "PJETËR BUDI", - PRISHTINË
PROGRAMI STUDIMOR (shëno cilin program)

TEMA BAÇELOR

(shënohet tema e punimit)

Mentori
Prof. _____
(shënohet emri dhe mbiemri i profesorit)

Studenti

(shënohet emri dhe mbiemri i juaj)

Prishtinë, 2016

Tel: 038 234 566, 044 163 372 / 049 163 372 / Email: pjeterbudi@gmail.com
www.pjeterbudi.com / Adress: Rr."Mujë Krasniqi"p.n.Ulpianë, Prishtinë



STRUKTURA E TEKSTIT

Përmbajtja

Teksti "PËRMBAJTJA" shënohet me shkronja të mëdha me fontin e shkronjave "BOLD", në rreshtin e parë të faqes së rreshtuar në qendër të faqes.
Në përmbajtje duhet të shënohen titujt, nëntitujt dhe numrin e faqes në të cilën gjendet tema e shtjelluar.

Hyrje

Shtjellimi i punimit BA fillohet me hyrje. Në fillim të hyrjes duhet të përshkruhet tema e shtjelluar dhe sqarimi i metodologjisë së përdorur për punimin e temës baçelor. Në hyrje duhet të paraqitet qëllimi dhe arsyetimi i punimit të temës. Varësisht prej temës, me disa paragrafë definohehen mënyrat e analizës së temës, respektivisht pikëpamjet e analizuara.
Në fund të hyrjes potencohen metodat shkencore me të cilat shërbehet studenti gjatë shtjellimit të temës.
Vërejtje: Hyrja duhet jetë e shkurtër dhe koncize, varësisht prej volumit të punimit, maksimumi një faqe.

Shtjellimi i temës

Gjatë shtjellimit të temës BA është e domosdoshme që tema të paraqitet qartë, duke i shfrytëzuar metodologjitë e hulumtimeve shkencore.
Tema e punimit BA duhet të ndahet në dy e më shumë pjesë, gjegjësisht në kapituj.

Konkluzionet

Pas përfundimit dhe përpunimit në tërësi të temës së paraqitur, duhet të nxjerrën konkluzionet – përfundimet. Numri i përfundimeve duhet të jetë minimum 3 (tri), varësisht nga tema e shtjelluar.

Vërejtje: Konkluzionet ose përfundimet duhet të nxirren nga shtjellimi i përgjithshëm i temës, e jo sikurse bëjnë disa, përshkruhet komplet hyrja në konkluzione).

Literatura e shfrytëzuar

Në renditje alfabetike përfshihen burimet – tekstet e shfrytëzuara, apo burimet nga interneti.
Për një punim Baçelor kërkohen minimumi 8 burime, libra shkencore, revista shkencore, tekste e dhe një numër i konsiderueshëm burimeve elektronike.

Vërejtje: Punimi baçelor mund të shtjellohet edhe pa burime elektronike nëse të mjaftojnë librat shkencore, revistat shkencore dhe tekstet e.



Vendosja e fusnotave (dokumentimi i burimeve)

Gjatë punimit të temës BA duhet të shfrytëzohet literaturë e ndryshme dhe duhet të bëhet dokumentimi i burimeve përmes vendosjes së fusnotave.

Vendosja e fusnotave bëhet në këtë mënyrë: *“Insert – Reference – Footnote”*¹

PARAMETRAT KRYESOR TEKNIK

Programi:	Microsoft Word
Paragrafi:	1.5
Lloji i shkronjave:	Times New Roman
Madhësia e fontit:	12
Formati:	A4 – me margjina standarde
Teksti:	I rreshtuar drejtë, pa hapësira “TAB”. Në mes të dy paragrafëve, hapësira (dy herë “Enter”).
Titujt:	Me fontin e shkronjave 16 “Bold”
Nëntitujt:	Me fontin e shkronjave 14 “Bold - Italic”

Punimi duhet të përmbajë 21 - 30 faqe.

¹ (Këtu shënohet: emri dhe mbiemri i autorit, titulli i librit, vendi dhe viti i botimit, faqja apo nëse është burim nga interneti shënohet saktë vendi i burimit).